



Gjuha shqipe është prej gjuhëve të pakta të cilat terminologjinë gjuhësore e kanë nga vet brumi i tyre. Kjo falë punës së palodhshme të rilindasve dhe mësuesve tanë të hershëm Sami Frashëri, Konstandin Kristoforidhi, Aleksandër Xhuvani, L. Gurakuqi, Xanoni, Rrota, Myderizi, Domi, e të tjerë.

Pra, në zanafillën e vet terminologjia jonë gjuhësore është thjesht shqipe. Por, natyrisht me shtimin dhe zgjerimin e studimeve gjuhësore kanë depërtuar edhe terma të huaj të cilët janë kryesisht ndërkombëtarë.

Nismëtar i parë i terminologjisë gjuhësore shqipe është Konstandin Kristoforidhi, kurse Sami Frashëri është themelues i vërtetë i saj, i cili me “Shkronjëtores” e tij na jep pothuaj një terminologji të plotë e cila vazhdohet nga një plejadë mësuesish të përmendur më lartë. Ndërsa, Aleksandër Xhuvani vërteton atë që ka dhënë Samiu në fonetikë dhe morfologji dhe vet i vë themelet e terminologjisë së sintaksës së sotme.

Më poshtë do të japim termat e dhënë nga Samiu dhe ato nga Xhuvani.

SAMI FRASHËRI

FONETIKË-MORFOLOGJI

SI ËSHTË DHËNË FORMA PËRFUNDIMTARE

Shkronjë (shkronjë)

B.sh.t: bukëtore (buzore)

Dhëmbëtore (dhëmbore)

Grykëtore (grykore)

Qiełltore (qiełlzore)

Termat:

Rrokje (rrokje)

Pikë (pikë)

Presje (presje)

Rrënjë (rrënjë)

Emni (emri)

Mbiemni (mbiemri)

Nyja (nyja)

Përemni (përemri)

Folja (folja)

Vetë (vetë)

Mënyrë (mënyrë)

Pësojtore (pësore)

Vetëvetore (vetvetore)

Pa veta (pavetore)

I tanishëm (i tashëm)

Mbiemrat: i përveçëm (i përveçëm)

I përgjithshëm (i përgjithshëm)

I shquar (i shquar)

I pashquar (i pashquar)

I njejshim (i nyjshëm)

I panyejshim (i panyjshëm)

Mashkullor (mashkullor)

Femëror (femëror)

Njënjës (njëjës)

Shumës (shumës)

Përemrat: vetëtorë (vetorë)

Dëftonjës (dëftorë)

Pyetës (pyetës)

Pronor (pronor)

Rasa: dhantore (dhanore)

Kallëzonjëtorë (kallëzore)

ALEKSANDËR XHUVANI

SINTAKSË

SI ËSHTË DHËNË FORMA PËRFUNDIMTARE

Termat:

Fjali (fjali)

E thjeshtë (e thjeshtë)

E zgjanueme (e zgjeruar)

Kryefjalë (kryefjalë)

Kallëzues (kallëzues)

Kall. Emnuer (kall.emror)

Kall. Foljuer (kall.foljor)

Kundrinë (kundrinë)

Cilësor (cilësor)

Ndajshtim (ndajshtim)

Plotësi (plotësi)

Plotësori (plotësori)

Samir Zullufi